



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA E PËRGJITHSHME SOCIALE DHE RINISË

**DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE, RINISË, STREHIMIT DHE SHËNDETIT
PUBLIK**

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____.____.2024

Lënda: Kthim përgjigje

Në përgjigje të kërkesës Suaj për informacion, administruar në Bashkinë Shkodër me Nr.24764 Prot., datë 22.10.2024, ju sqarojmë se:

1. A ka bashkia një Plan Social të miratuar dhe nëse po kur është miratuar?

Bashkia Shkodër aktualisht nuk ka të miratuar plan social. Ka përfunduar procesi i hartimit të planit të ri social dhe aktualisht jemi në fazë konsultimi, por nuk është miratuar ende në Këshill Bashkiak. Plani i fundit i miratuar është plani social 2018-2021.

2. A ka aplikuar Bashkia Shkodër për të përfituar nga Fondi Social dhe a jeni shpallur fitues në vitin 2024?

Bashkia Shkodër nuk ka aplikuar në thirrjen e vitit 2024 për të përftuar nga Plani Social.

3. Sa ka qenë vlera totale e miratuar nga MSHMS për vitin 2024 dhe për cilat kategori shërbimesh do të përdoren?

Bashkia Shkodër ka aplikuar pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me shkresën Nr. 4307 Prot., datë 10.12.2021 për Fondin Social për Shërbime me Bazë Komunitare 2022 me projekt – propozimin “Strehëz për fëmijët pa kujdes prindëror”, me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së financimit të Strehëzës për fëmijët pa kujdes prindëror, strukturë e ngritur nga Bashkia Shkodër në bashkëpunim me ACLI-IPSIA.

E përzgjedhur si bashki fituese dhe e vlefshme për financim përmes shkresës të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) Nr. 1134/19 Prot., datë 04.05.2022 “Njoftim për

përzgjedhjen fitues të projekt propozimit “Strehëz për fëmijët pa kujdes prindëror”, Strehëza filloi funksionimin e saj të plotë më 01.06.2022.

Me anë të këtij shërbimi të ri dhe alternativ është ofruar një mundësi për fëmijët pa kujdes prindëror, të cilët nuk mund të rriten në një mjedis familjar, duke synuar gjithashtu përfshirjen brenda procesit të de-institucionalizimit dhe të decentralizimit të nisur në Shqipëri, kryesisht referuar Planit Kombëtar të De-Institucionalizimit 2020-2022 të miratuar me VKM Nr. 706, datë 09.09.2020 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit të Fëmijëve 2020-2022” dhe të Planit të Veprimit në zbatim të tij. Struktura përmbush standardet për shërbimet e përkujdesit shoqëror të përcaktuar në VKM Nr. 659, datë 17.10.2005 “Për standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për fëmijët në institucionet rezidenciale”.

“Strehëza” përdor një model marrëdhëniesh, që paraqitet si alternativë e përkohshme ndaj modeleve institucionale të qendrave rezidenciale dhe në përgjithësi, ndaj institucioneve të mëdha, modele që fatkeqësisht vazhdojnë të funksionojnë në vendin tonë. Organizimi i strukturës, duke filluar prej hapësirave fizike deri te veprimtaritë ditore, janë pjesë përbërëse e ndërhyrjes edukative dhe synojnë riparimin e dështimeve të mëparshme ambientale. Gjithashtu, ky shërbim synon të ofrojë edhe strehim emergjent të sigurtë dhe rehabilitues për fëmijët në situata emergjente apo në rrezik të lartë deri në rehabilitimin e plotë të fëmijëve dhe të familjes biologjike me qëllim që të minimizohet koha e qëndrimit të të miturit në “Strehëz”.

Sipas aplikimit, kohëzgjatja e projektit është 36 muaj (Janar 2022 – Dhjetor 2024), dhe transferimi i fondit në buxhetin e Bashkisë Shkodër është planifikuar të bëhet me tre këste:

- Financimi i vitit të parë në masën 90% të totalit të kostove të ofrimit të shërbimit, ku në fakt ky financim është disbursuar në maj të vitit 2022 në shumën 7,841,995 Lekë. që përkon në mënyrë përpjësimore me 7 muaj shërbim;
- Viti i dytë i zbatimit të projektit është financuar në masën 60% të vlerës së projektit;
- Viti i tretë i zbatimit të projektit është financuar në masën 30% dhe do të vazhdojë edhe në vitet në vazhdim referuar udhëzuesit social për vitin 2022.

Vlera totale e miratuar nga MSHMS-ja për vitin 2024, ka qenë 4,158,672 lekë, për “Strehëzën për fëmijë pa kujdes prindëror”.

4. A është disbursuar në masën 100% fondi i kushtëzuar i MSHMS për vitin 2024?

Për vitin 2024, fondi social i disbursuar për 8 mujorin e vitit 2024 është 49% dhe është në proces zbatimi deri në fund të vitit 2024.

5. A keni përthithur fonde nga Fondi Social për vitin 2023, në çfarë vlere ka qenë fondi i përfituar dhe për cilat kategori shërbimesh janë përdorur?

Fondi për “Strehëzën për fëmijë pa kujdes prindëror” ka qenë në vlerën 8,612,016 lekë. Në strehëz ofrohet shërbim për 8 fëmijë të moshës 6 deri në 18 vjeç.

6. Sa përqind të fondit të përfituar keni përdorur deri tani të ndarë sipas viteve, 2023 dhe 2024?

Për vitin 2023 është përdorur fondi prej 7,291,000 lekë.

Për vitin 2024, referuar realizimit 8 mujor të buxhetit, janë shpenzuar 2,031,000 lekë.

7. A keni parashikuar në buxhetin afatmesëm 2025-2027 ngritje të fondeve për të mbajtur në funksion shërbimet e ofruara në territor edhe pas përfundimit të financimit të Fondit Social?

Në buxhetin afatmesëm 2025-2027 është parashikuar fond për të mbajtur dhe ofruar shërbimin e ngritur për “Strehëzën për fëmijë pa kujdes prindëror”.

8. Cilat janë kategoritë e shtresave vulnerabel të identifikuar në bashkinë tuaj që mund të përfitojnë nga shërbimet sociale?

Sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, përfituesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror përfshijnë këto grupe shoqërore:

- a) familjet dhe çdo fëmijë, si dhe fëmijën që gëzon mbrojtje ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë, sipas legjislacionit në fuqi për azilin;
- b) personat me aftësi të kufizuara;
- c) të rriturit, me probleme sociale, viktimat e dhunës, trafikimit, varësisë së provuar ndaj drogës e alkoolit;
- ç) vajzat shtatzëna apo prindi i vetëm i një fëmije deri në moshën njëvjeçare;
- d) të miturit dhe të rinjtë në konflikt me ligjin, që kanë përfunduar periudhën e dënimit dhe kanë nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror, me qëllim riintegrimin në shoqëri, si dhe ata që gëzojnë mbrojtje ndërkombëtare me vendim të autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët në Republikën e Shqipërisë;
- dh) të moshuarit në nevojë.

Duke ju falenderuar,

KRYETAR

Benet Beci

